



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10578 prot.

Shkodër, më 06.05. 2026

VENDIM

Nr. 38, datë 30.04.2026

**PËR NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 84, DATË 18.12.2025 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2026–2028 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 45 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, i ndryshuar; VKM-së nr. 38, datë 19.01.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga MIE, dhe Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e ‘Projektit të bashkive me energji inteligjente (SEMP)’”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; VKB-së nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23029/1 prot., datë 27.12.2022 “Akordim fondesh në kuadër të projekteve me financim të huaj”, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e planit në Buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB-në nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, në programin AD141 “Planifikimi dhe kontrolli i territorit dhe mjedisit”, për projektin “Investime në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie”, në vlerën 10 126 800 lekë, sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23029/1 prot., datë 27.12.2022 “Akordim fondesh në kuadër të projekteve me

financim të huaj” – fond MFE për pagesë bashkëfinancimi për projektin “Bashki me shfrytëzim inteligjent të energjisë (SEMP) (SECO)”, sipas detajimit më poshtë:

Nr	Kap	Programi	Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime kapitale të trupëzuara	Institucioni
1	1	AD141 “Planifikimi dhe Kontrolli i territorit dhe Mjedisit”	P.AD141.Q4.01.A3/1; Investime në kuadër të projektit Bashki të zgjuara energjie.(Shtesë) A1. Investime/ zbatim në kuadër të projektit Bashki të zgjuara energjie (Rruga“ Isuf Sokoli”)	9,998,409	Bashkia Shkodër
2			A3 Mbikqyrje e Investimit Bashki të Zgjuara Energjie (Rr. “Isuf Sokoli”)	110,000	Bashkia Shkodër
3			A4. Kolaudim Investimi Bashki të Zgjuara Energjie (Rr. “Isuf Sokoli”)	18,391	Bashkia Shkodër
		TOTALI LEKË		10,126,800	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 38 vota

Vota Pro 38
Vota Kundër 1
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.05.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

